



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:204076

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05489399

**PKR.nr.228/2022**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti për Krime të Rënda**, duke vendosur sipas kryetarit të trupit gjykues Naser Maliqi, anëtarët e trupit gjykues Menderes Behluli dhe Mevlide Shabani, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në çështjen penale të pandehurve; **Xh.I** nga Mitrovica, te cilin e mbron Av. Blerina Dermaku nga Gjilani, **B.Z** nga .....K. Mitrovica, të cilin e mbron Av. Elbasan Alidema nga Gjilani dhe **G.P** nga f. .... K. Mitrovica, te cilin e mbron Av. Amir Zymberi nga Gjilani, Xh.I dhe B.Z për shkak të veprës penale mashtrim nga neni 323 paragrafi 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-se dhe Xh.I, B.Z e G.P për shkak të veprës penale rrëmbim nga neni 191 par.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-se, e sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.229/2022 të datës 23.11.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik me datën 18.03.2024 në të cilin kanë prezantuar prokurori i shtetit Bahtie Ademi, të akuzuarit, me mbrojtësit e tyre sipas detyres zyrtare, në të njëjtën ditë shpalli ndërsa me datën 22.03.2024 përpiloi këtë:

**AKTGJYKIM**

**1.Xh.I**, nga babai H dhe nëna S, e lindur G, e lindur më..., në Mitrovicë, ku edhe jeton me adresë në rrugën.... ka të kryer Shkollën fillore, e pa martuar, me profesion këngëtare, me numër personal...., me gjendje të varfër ekonomike, me numër telefoni...., shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, **(në masë të paraburgimit nga data 04.10.2022 deri me datë 03.11.2022, nga data 03.10.2022 në masë të arrestit shtëpiak e tutje.**

**2.B.Z**, nga babai I dhe nëna Xh, e lindur O, i lindur më..., në fshatin ....Komuna e Skenderajt, me vendbanim në Mitrovicë,....”, ka të kryer Shkollën fillore, i martuar, prind i tre fëmijëve, me profesion zdrukthëtar, i pa punë, me gjendje të dobët ekonomike, me numër personal...., me numër telefoni...., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **(në masë të paraburgimit nga data 04.10.2022 deri me datë 03.11.2022, nga 03.10.2022 në masë të arrestit shtëpiak e tutje.**

**3.G.P**, nga babai N dhe nëna S, e lindur G, i lindur me datë..., në fshati..., Komuna e Zveqanit, ku edhe jeton, ka të kryer Shkollën e mesme, i martuar, prind i tre fëmijëve, me profesion mirëmbajtës në Kullën “...” në..., me gjendje të varfër ekonomike, me numër personal..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ( **në masë të paraburgimit nga data 04.10.2022 e deri me datë 03.11.2022, nga 03.10.2022 në masë të arrestit shtëpiak e tutje.**

**Ne baze te nenit 362 paragrafi 1 pika 1.1, neni 453 paragrafi 1 dhe neni 462 par. 1 dhe 2 te KPPRK-se**

**Për të akuzuarit Xh.I e B.Z;**

**I.**

**REFUZOHET AKUZA**

**SEPSE**

Gjatë periudhës kohore, si në dispozitivin I., me qëllim të përFit të kundërligjshëm pasuror për vete apo personin tjetër, me anë të paraqitjes së fakteve të rreme, duke i venë në lajthitje i mashtrojnë të dëmtuarit B.H, K.H, A.J, F.R F.Sh dhe G.P, në atë mënyrë që fillimisht të pandehurit Xh.I dhe B.Z i njoftojn të dëmtuarit me të pandehurin R, e më pasë edhe ju thonë se i pandehuri R me para, ka mundësi ti rregulloi dokumentacionin si; pasaportë serbe dhe greke dhe të iu caktoi në ambabasadën e shtetit të Gjermanisë termine pune, në këtë mënyrë edhe binden të dëmtuarit të iu japin para përveq te pandehurit R edhe të pandehurit B, me c’rast i pandehuri B në fund të muajit korrik 2022 nga i dëmtuari F merrë 400 euro, ndërsa nga i dëmtuari F merrë 455 euro, kinse për t’ia dhënë të pandehurit R, në ketë mënyrë të pandehurit me veprimet e tyre i mashtrojnë tani te demtuarit e lartcekur, me c’rast u shkaktojnë dëm material, në vlerë të pa përcaktuar.

**-me çka kishin me kry vepren penale mshtrimi nga neni 323 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se.**

Ne baze te nenit 363 paragrafi 1 pika 1.3, neni 453paragrafi 1 dhe neni 462 par. 1 dhe 2 te KPPRK-se

**Te akuzuarit Xh.I, B.Z dhe G.P;**

**II.**

**LIROHEN NGA AKUZA**

**SEPSE**

**Nuk është vërtetuar** se me datë 04.tetor 2022, rreth orës 19:30 minuta, në afërsi të pikës kufitare “Dheu i Bardhë” me dashje dhe duke vepruar në bashkëveprim, e kanë sulmuar tani të dëmtuarin R I, për shkak se ky i fundit i kishte mashtruar duke iu marrë para në kembim të rregullimit të dokumentacionit për punë në Gjermani, ashtu që me të arritur të pandehurit afër pikës kufitare “Dheu i Bardhe” ndalin për ta pritur të demtuarin R, me c’rast i pandehuri B

fillimisht e fyen, e me pasë edhe dy të pandehurit e godasin me grushta në pjesë të ndryshme të trupit tani të demtuarin R, e pastaje i dëmtuari R arrinë të ikë nga vendi i ngjarjes.

**-Me cka kishin me krye veprë penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 te KPRK-së.**

**Shpenzimet** lidhur me këtë lëndë penale mbesin në barre të mjeteve buxhetore të KGJK-së.

**Te demtuarit** B.H, K.H, A.J, F.R F.Sh dhe G.P, per realizimin e kërkesës pasuror-juridike udhëzohen në kontest civil.

## **A R S Y E T I M**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, me 23.11.2022 , ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.229/22 , ndaj të pandehurve Xh.I nga Mitrovica, të cilen e mbron Av. Blerina Dermaku nga Gjilani, B.Z nga f. ... K. Mitrovicë, të cilin e mbron Av. Elbasan Alidema nga Gjilani dhe G.P nga f. ....K. Mitrovicë, të cilin e mbron Av. Amir Zymberi nga Gjilani, Xh.I dhe B.Z për shkak të veprës penale mashtrim nga neni 323 paragrafi 1 e lidhur me nenin 31 te KPRK-së dhe Xh.I, B.Z e G.P për shkak të veprës penale rrëmbim nga neni 191 par.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 te KPRK-së , dhe ka kërkuar që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Për të pandehurin R I ka përfunduar procedura penale, për shkak se i njëjti e ka pranuar veprën penale e cila i vëhet në barre, mashtrim nga neni 323 p.1 të KPRK-së, Aktgjykimi i po kesaje gjykate PKR.nr.219/2022 date 06.12.2022, ndersa ndaj te pandehurve te tjere ishte veq procedure penale.

Prokurorja e rastit Bahtie Ademi, në fjalën përfundimtare me date 18.03.2024 ka hequr dorë nga ndjekja penale ndaj të akuzuarve Xh.I dhe B.Z për shkak të veprës penale mashtrim nga neni 323 paragrafi 1 te KPRK-së, për këtë arsye gjykata ka refuzua akuzën ndaj të njëjtve.

Seanca e shqyrtimit gjyqsore e datës 06.06.2023 ka filluar nga e para, për shkak se në vend të anëtarit të trupit gjykues Veli Kryeziu I cili ka kishte udhtuar jasht vendit, është caktuar gjyqtari Menderez Behluli.

Me dakordimin e palve në procedurë janë lexuar dëshmitë e dëshmitarve të dëgjuar me herët.

Edhe seanca e shqyrtimit gjyqsorë e datës 11.12.2023 ka filluar nga e para, për shkak se në vend të anëtarit të trupit gjykues Aziz Shaqiri I cili kishte shku në pension, e në vend të tijë është caktuar gjyqtarja Mevlide Shabani.

Me dakordimin e palve në procedurë janë lexuar dëshmitë e dëshmitarve të dëgjuar më herët.

E njëjta prokurore, gjithashtu në fjalën përfundimtare për të akuzuarit Xh.I, B.Z dhe G.P, ka bere rikualifikimin e veprës penale në dispozitivin III te aktakuzes, nga vepra penale rrëmbim nga neni 191 par.1 e lidhur me nenin 28 e 31, në veprën penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 e 31 të KPRK-së.

## **Procedura e provave;**

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit **B.H ka deklaruar**, ditën kritike kam qenë në veturë me A.Jn, F.R dhe K.H dhe jemi dal për me bisedu me R In. E kemi pritë në Gjilan dhe Xh na ka treguar se ai do të vjen në Gjilan. Na kemi prit dikun në rrugë por nuk e njoh Gjilanin unë spe di ku.

Xh na tha neve se po shkojmë deri në kufi me kqyr a kanë ardhë . Xh ka qenë bashkë me Gn dhe Bn në veturë dhe F.Sh. Në atë vend në Gjilan kemi prit gati gjys ore por nuk ka ardhë R I. Pasi pritëm aty dhe nuk erdh kërkush, neve na lindi ideja me shku në kufi me kqyr çka ka ndodhë. Duke shkuar nga kufiri, afër kufirit e kemi takuar R In ishte duke ecur në këmbë duke shkuar kah kufiri me Sërbin. Na e ndaluam veturën të cilin e vozitëse F.R dhe i thamë Rit hynë në kerr se dojmë me pi kafe. Ri ka hyrë në kerr dhe na e kthyer kerrin drejt me pru në Polici në Gjilan. Kur ka hyp në kerr Ri të paren fjalë ka pyet ku po më qoni, na 4 vet që kemi qenë brenda në veturë i kemi thanë se po të qojmë në Polici në Gjilan për punën vizave . Ai na u lut veq lëshonim se paret i keni jav kthej .

Mirëpo na e patëm hup B tek ai.

**Nuk e ka shti askush në veturë me dhunë.**

Ne prej Mitrovicë të gjithë jemi nisur duke përfshirë edhe të akuzuarit që të takohemi me Rin dhe të bisedojmë për këtë punë , a po na i kthen paret dhe kur po na i kthen paret. Kur jemi nis nuk ka pas kurrfarë bisede as nga të akuzuarit se do ta rrëmbejnë Rin për shkak të parave.

**Në gjykatore ftohet dëshmitari K.H**, ka thene se R In nuk e kam njohur më herët por e njoh tani në bazë të Xh dhe Bsë.

Me Rin jemi takuar në Mitrovicë në një qajtoje ku ka qenë prezent Ba i cili tha me Rin jam bagjanak edhe G ka qenë aty prezent ndërsa Xh nuk ka qenë në atë qajtoje. . Unë aty rusisht jam takuar. Gn dhe Bn e pyta se kush është ky ata më thanë se është R I nga Bujanovci.

Ditën kritike jemi marrë vesh që me ardhë në kufi me Sërbinë tek Dheu i Bardhë, për me u taku me R In me vet çka u bo me letra ose paret me na i kthy ose dokumentat me na i kry. Nga Mitrovica jam nis me 2 vetura , unë me B, Fin Sh, ndërsa në veturën tjetër G , Ba , Xh dhe A. Vetura që kanë qenë tani të akuzuarit kanë qenë para neve nja 200 – 300 metra. Kur kemi shkuar afër kufirit, Ri ish kanë në kam tu hec në drejtim të Gjilanit, e kemi nal veturën e kemi pyet a po na jep paret a dokumentet, ai na tha as nuk kam pare as dokumente.

**Dikush prej neve, por nuk më kujtohet cili i ka thënë hajde shkojmë pim kafe dhe ai ka hyrë në kerrin tonë.**

R I si ka hyrë në veturë tha ku po më qoni, dikush prej neve i ka thën se po të dërgojmë në Polici, i njëjti ka pyte për çka, ne e i tham se na ke mashtru ani qonum drejtë në Polici.

Jan ndale nga policia, i kanë qitë shpejt prej kerrit na kanë prangos, Rin e kan shti në një veturë menjëherë, na kanë largu dhe na kanë qu në Polic menjëherë.

Nuk na dhanë ndonjë arsye pse na prangosën, policia na tha se nuk bon me shti njërin në veturë kështu, a na nuk e kemi marrë Rin me zor por me dëshirë. Kur e kemi parë Rin duke ecur në këmbë në drejtim të Gjilanit ne kemi qenë me veturë duke u afruar në drejtim të kufirit. E kemi nal veturën dhe kemi bo muahabet siç duhet. Kur e kemi parë Rin ai ka qenë duke ecur jo duke vrapuar veq e di se ka qenë errësirë rreth mbrëmjes duke u terruar unë nuk e di se çfarë gjendje emocionale ka qenë . Pasi që jemi taku me Rin biseda ka zgajnt nja 4-5 minuta e pasaj për Gjilan jemi nise.

**Në gjykatore ftohet dëshmitari F R, ka thene se** kur e kemi vendos me ardhë në Gjilan, në kufirin me Sërbi, thjesht jemi tubu në Mitrovicë dhe me ardhë secili mu interesu për dëmin që iu ka shkaktu. Unë nuk dyshoj në të akuzuarit se kanë pas ndonjë lidhje apo pëf nga R I. Jemi nise me dy vetura nga Mitrovica rreth orës 15:00 dhe unë kam qenë në veturë me K.Hn , B.H dhe F.Sh, ndërsa veturën e kam drejtuar unë.

Kur e kemi ndal veturën në afërsi të kufirit, më nuk e kemi pa veturën e të akuzuarve.

Deri sa ishmi nal ne afër kufirit e ka thirr G, A.J në telefon dhe i ka thën se te ne Ri nuk erdh në kerr dhe pastaj ne kemi vazhdu në drejtim të kufirit ku e kemi takuar R In duke shkuar në drejtim të kufirit. **E kemi nal veturën dhe e thirrëm Rin dhe i tham na prej veturës a kishe mujt me ardh me pi kafe, i nejt i ka thanë po, ka hyrë në veturë me dëshirë , kur jemi kthyer për Gjilan , e rrugës Rid i kemi tregu se nuk po pim kafe por po të qojmë në Stacion Policor në Gjilan.** Ai na ka lut duke thanë pash zotin më jepni afat 2 ditë se jav kthej paret, jav kryj punën duke vazhduar me avazin e vjetër. duke ardhur në Gjilan na ka ndal patrulla e Policisë dhe neve na kanë nal përpara. Masi jemi dal prej kerrit, Ri iu ka thanë se kta nuk kanë faj, se është edhe një veturë tjetër. Pas neve ka ardhë edhe vetura e tani të akuzuarve, e që është ndal nga Polica i edhe na dërgun në Stacion Policor.

**Në veturën tone Ri ka hyrë me shumë dëshirë.** Nuk e kam pyet Rin pse nuk ka hyrë në veturën e tani të akuzuarit.

Qëllimi i krejt neve, kur jemi nis prej Mitrovice për në Gjilan, ka qenë me bisedu me Rin për çështjen e vizave.

Nga prokurorja e shtetit eshte propozu qe R I te ndegjohet ne cilsine e deshmitarit, mirpo pas shume perpjekje te gjykates, I njejt i nuk ka mundur te sigurohet. Deklarata e tije e dhene ne Polici dhe Prokurori nuk ka mundur te lexohet, sepse I njejt i eshte degjuar vetem ne cilsine e te pandehurit.

**Dëshmitari F.Sh, ka thene se** ditën kritike kur jemi nis për Gjilan, paraprakisht unë jam taku me Fin, kena bisedu, pastaj u ardh B që është i dëmtum në këtë rast, dhe G , kena pi kafe dhe kena vendos mi shku te shpia e Rit në Bujanovc, sepse Gj e ka dite dhe jena bo bashk dhe jemi nis për Gjilan. Nga Mitrovica jemi nise me dy kerre, në veturën ku kam qenë unë ka qenë Fi, B dhe K, në veturën tjetër ka qenë Gj, Ba, G dhe A i cili është dëshmitar në këtë rast. Rrugës duke shkuar për Gjilan, Gj kish fol me telefon me Rin, i njëjt i ka thane nuk keni nevojë me ardhë në Bujanovc por unë po vi për Gjilan. Dy kerret jemi nal diku afër kufinit por nuk e dij saktësisht se ku, sepse nuk e njoh vendin. Duke ardhur ka Gjilani kerri i tani të akuzuarëve ka qenë përpara. Kur jemi ndal aty pastaj jemi ba bashkë krejt, sepse unë kam qenë bashk tani me të akuzuarit kur ka ardhë Ri. Ri ka ardhë në këmbë e me cka ka ardhë deri aty nuk e dine, por në këmbë e kam pa. I kemi thonë që të gjitha ku je R, ku je hup, ku je zhduk. Pastaj i kemi thon hajde shkojna pina kafe e mirmi vesh për qat punë, Ri nuk dojke me ardhë me neve, u tutke prej neve sepse na i tham nëse nuk naj kthen paret kemi met qu në Stacion të Policise, kur i ndëgjoj këto fjalë ai u qart, u tensionu dhe iku. Ri iku në drejtim të kufinit me u kthy në vend të vet. Kerre kan kalu nonstop po nuk e dij se a ka vërejtë najkush, Ri ka vrapu përshejt rrugës në drejtim të kufirit, ndërsa prej neve kërkush nuk ka dasht me nal me zorr. Unë nuk e kam vërejtë se Ri ka hyrë në veturën tjetër. Unë Rin e kam pa në Stacion të policis kur kemi mbërri aty. Paret nuk më janë kthyer.

**Dëshmitari E.K** ka pohu, se ditën kritike me një shok timin S.V kemi qenë në Prishtinë dhe duke u kthyer për në Bujanovc, me të arritur afër doganës ndërmjet terminalit Doganor dhe vijës kufitare me Sërbinë i kemi parë disa njerzë në rrugë, që kanë qenë duke u rrahur

ndërmjet vete, ne ata i kemi parë duke u rrahur, sepse i kemi pas dritat e veturës të ndezura, ka qenë natë. Nuk e di se sa ka qenë ora.

Në vendin ku kanë qenë duke u rrahur disa persona, ka qenë edhe një automjet Vectra i parkuar afër rrugës, nëse nuk gaboj llojin e automjetit ngjyrë e kuqe, sa e mbaj në mend targa e automjetit ka qenë 02 por shënimet tjera nuk e di dhe në automjet brenda ka qenë një grua në vendin e shoferit me flok të bardha, por nuk e njoh atë grua. **Edhe pas kërkesës së kryetarit të trupit gjykues që të shikoj në sallë se a mos është prezent ajo grua, pas shikimit të bërë, dëshmitari deklaron se jo nuk e njoh.** Aty kanë qenë duke u rrahur 3-4 persona dhe aty ka qenë edhe R I, i cili në ato momente ka qenë duke ikur në drejtim të pikës kufitare Dheu i Bardhë, ndërsa disa persona e kanë ndjek përmbropa.

Unë me shokët e mi nuk kemi ndërmarrë asnjë veprim, nuk kemi zbritur prej veture se po ndodh diçka.

Ri ka dal në rrugë dhe i ka lut njerzit që ta merr dikush në veturë, mirpo ne jemi tut e nuk e kemi marrë askush. Me Rin unë nuk kam kontakt por vetëm e kam njohur si figurë. Ne me veturën tonë kemi shkuar deri te pika kufitare dhe ai shoku im që ka qenë S.V e ka denoncu rastin në Polici, mirëpo unë e kam pohu me gojë se po ka ndodhë dhe kemi kërku që të marrin masa se njeri ishte në rrezik.

Rrahja ka ndodhë përfaqësisht në trotuar, saktë nuk e di .

Nuk i kam vërejtur ata persona që kanë pasur diçka në dorë .

Unë pas rastit nuk jam takuar me Rin, ndërsa e vërteta është që Ri dhe ata persona atë natë ata janë arrestuar dhe unë kam qenë në Stacion Policor me dhënë deklaratë së bashku me S, mirëpo me Rin nuk jemi takuar e as deri në ditën e sotme.

Babën e Rit unë e kam djal teze, kjo është arsye që unë e kam njohur Rin.

### **Unë këtu nuk po e njoh asnjë person që ka marrë pjesë në atë rrahje.**

**Dëshmitari S.V**, ka thënë se data nuk më kujtohet, por e di ngjarjen se si ka rrjedh. Ashtu që ditën kritike kam qenë në Prishtinë me shokun tim E.K, duke u kthyer nga Prishtina për në vendlindje, dhe kur kemi shkuar te kufiri Kosovë- Sërbi, tek dheu i bardhe, afër terminalit , kam par tri vetura, vetura e parë që e kam par, ka qenë Gollf II , me ..., Gollf 5, me ..., dhe një veturë tjetër me ..., dhe disa persona duke u kacafytur me një person që më në fund ka kërkuar ndihmë duke bërë me dorë dhe duke vrapuar në drejtim të kufirit. Pasi kemi mrri në kufi, në atë moment shoku im E, më tha se ka qenë Ri duke ik dhe unë e kam lajmëruar rastin në polici, në kufi tek policia e Kosovës.

Nuk më kujtohet se sa persona kanë qenë aty, ka qenë mbrëmje por nuk e di se qfar kohe dhe errësirë.

Duke ike e kam par at personin e quajtur R, por zërin nuk ja kam ndëgjuar, pasi xhamat i kam pasur të mbyllur. Kur i kam par ata katër persona siq e ceka më lartë, kam qenë diku afër 5 metra larg. Këta kanë qenë në anën e djathtë anash rrugës, aty nuk ka pasur ndriqim, por vetëm ndriqimi i makinave. Unë kam qenë duke vozit dhe nuk i kam par.

**Unë nuk mundem me identfiku asnjërin nga të akuzuarit, që kanë qenë në atë kacafytje.** Personat që kanë qenë duke u kacafytur dhe veturat kanë qenë të personave tjerë.

### **Leximi I shkresave;**

-Raporti I hetimeve NJHP 186-22 date 5. Tetor 2022,

-Raporti fillesatr I incidentit date 4 tetor 2022,

-Vertetimi mbi sekuestrimin e sendeve date 04.tetor 2022, ku nga të akuzuarit janë sekuestruar telefonat celular.

-Raporti mbi automjetin e terhequr,

-Te dhenat mbi databaza e policies ne emer te Xh.I,

-Deftesa mbi konfiskimin e prones date 4 tetor 2022 dhe

-Raporti I oficerit date 04.tetor 2022.

Ne seancen e dates 12.03.2024 prokurorja e shtetit Bahtie Ademi ka hequr dorë nga dëgjimi I deshmitarit A.J, sepse eshte konfirmuar nga Policia e Kosoves, Stracioni policer ne Mitrovice, se I njehti ndodhet jasht vendit dhe tani eshte I paqasshem.

### **Mbrojtja e te akuzuarve;**

Të gjithë të akuzuarit kan deklaruar se deshirojn të mbrohen në heshtje.

### **Fjala përfundimtare e palëve;**

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se heqë dore nga ndjekja penale për të akuzuarit Xh. I dhe B.Z, për shkak të veprës penale mashtrim nga neni 323 par.1 e lidhur me nenin 31 te KPRK-se në mungesë të provave.

Ndërsa sa I perket vepres penale nënë dispozitivin III. te aktakuzes, rrembim nga neni 191 par.1 neni 28 dhe 31 te KPRK-se e ka bërë relkualifikimin në vepër penale sulmi nga neni 184 par.1 e lidhur me nenin 31 te KPRK-së, për të akuzuarit Xh.I, B.Z dhe G.P.

Konsideron se vepra e rekualifikuar është kryer nga ana e të akuzuarve, ka kërkuar që të shpallen fajtorë dhe denohen me denim meritator sipas ligjit. Ka kërkuar të merren parasysh rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese gjatë marrjes së vendimit.

Pas rekualifikimit si me lartë të vepres penale, gjykata përseri ka degjuar të akuzuarit lidhur me vepren penale të rekualifikuar, mirpo asnjëri nga ta nuk e ka pranuar fajsinë.

**Mbrojtsja e te akuzuares Xh.I, Av. Blerina Dermaku** ka kërkuar nga gjykata që të merrë aktgjykim lirues për të mbrojturën e vet, sepse me asnji provë nuk është vërtetu fajsia e sajë.

**E akuzuara Xh.I** e ka përkrahë fjalën përfundimtare të mbrojtjes, ka kërkuar lirim nga përgjegjësia, sepse është e pa fajshme.

**Mbrojtsi I të akuzuarit B.Z, Av. Elbasan Alidema** ka kërkuar që I mbrojturi I tijë të lirohet nga akuza.

**I akuzuari B.Z** ka kërkuar lirimin e tijë.

**Mbrojtsi I të akuzuarit G.P, Av. Amir Zymberi,** ka kërkuar lirimin e të mbrojturit të tijë, sepse nuk është vërtetu as vepra penale e rekualifikuar nga ana e prokurorës.

**I akuzuari G.P** ka kërkuar lirimin e tijë.

**Pas analizimit të hollësishëm të provave të administruara**, gjykata konstatoi; se nuk është vërtetë se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka degjuar dëshmitarët B.H, K.H, F.R e F.Sh, të cilët pothuaj se në mënyrë identike kanë deklaruar, se I demtuari R I nuk është rrahur nga tani të akuzuarit dhe as që është tentuar që të futet në veturë me dhunë. Të njëjtit I është thënë që të vjen në veturë me shkuarje me pi kafe, e kur I është thënë, se do ta dergojnë në polici, ai ka reaguuar duke u premtuar se paratë që I kishte marrë do të kthente për dy ditë, ketzre dëshmitarëve gjykata ua falë besimin, sepse dëshmitarët e tjerë janë identike.

Dy dëshmitarët E.K dhe S.V, në vendin e ngjarjes e kishin identifikuar ish të akuzuarin R I, I cili kishte qenë duke ikur kah kufiri me Serbinë dhe disa persona duke u kacafytur me të. Mirpo asnjëri dëshmitarë nuk I ka identifikuar se tani të akuzuarit kanë qenë ata persona që e kanë rrahë apo ndjekur Rin.

Për këtë arsye gjykata është e bindur se nuk ka prova, se të akuzuarit e kanë sulmuar R In.

Kështu gjykata për të akuzuarit ka prurë aktgjykimin lirues për veprën penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në mungesë të provave.

Pas rëkualifikimit të veprës penale nga ana e prokurorës, gjykata ka bërë edhe përmirsimin e dispozitivit, përshtatjen me veprën penale, sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës kanë mbetur në barë të mjeteve buxhetore të KGJK-së.

Të demtuarit janë udhëzuar në contest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Sa I përket provave materiale të propozuara nga ana e prokurorisë, raporteve policore, gjykata I ka konsideruar të pa rëndësishme për vërtetimin e gjendjes faktike, të njëjtat nuk e kanë cilësuar e provës, por vetëm janë informata me të cilat shërbehet policia, me të cilat mundë të informon edhe prokurorin e qështjes për ecurinë e hetimit.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**Më datën 22.03.2024**

**S. Juridike;**  
Kadrije Zymberi

**Kryetari i trupit gjykues**  
Naser Maliqi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, palët e pakënaqura mund të ushtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.



Numri i lëndës: 2022:204076  
Datë: 22.03.2024  
Numri i dokumentit: 05489399